



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 384/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.06.2017 shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Biba X” sh.p.k & “Arti” sh.p.k. & “Senka” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Rikonstruksioni rrugës “Ura e Çurumit – Zhabiak – Ura e Çepanit” me Nr. REF-73360-03-22-2017, me fond limit 261.111.695 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 24.04.2017 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë
“Biba X” sh.p.k. & “Arti” sh.p.k. & “Senka” sh.p.k.
Adresa: Kryeluzaj, 50 m pranë karburant “Eurodrin”, Kavajë

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, Nr.10, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të

Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1 Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.03.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Rikonstruksioni rrugës “Ura e Çurumit – Zhabiak – Ura e Çëpanit” me Nr. REF-73360-03-22-2017, me fond limit 261.111.695 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 24.04.2017 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 24.04.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, rezulton se në datën 09.05.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Alba Konstruksion” sh.p.k.	161.535.227	lekë	kualifikuar
2. “Biba X” sh.p.k.	161.874.915	lekë	skualifikuar
3. “Mela” sh.p.k.	165.000.000	lekë	skualifikuar
4. “Lala” sh.p.k.	180.258.791	lekë	skualifikuar
5. “2T” sh.p.k.	181.682.963	lekë	skualifikuar
6. “Vëllezërit Hysa” sh.p.k.	183.387.595	lekë	kualifikuar
7. “Shkëlqimi 07” sh.p.k.	183.500.000	lekë	skualifikuar
8. “G.P.G” sh.p.k.	184.821.851	lekë	skualifikuar
9. “Integrated Technology Services” sh.p.k.	209.573.979	lekë	skualifikuar
10. “PE – VLA – KU” sh.p.k.	213.810.384	lekë	skualifikuar
11. “4 AM” sh.p.k.	219.069.629	lekë	kualifikuar
12. “VARAKU E” sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike		

II.3.1. Operatori ekonomik “Biba X” sh.p.k. është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se:

“[...] Shoqëria “Biba X” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën 2.a. të Kërkesave të Përgjithshme për Kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve fiskale pasi sipas vërtetimit të paraqitur rezulton se ka detyrime tatimore në shumën 10.101.319 lekë, për të cilat nuk është ankimuar në gjykatë. Duke qenë se kjo është një e metë thelbësore, komisioni vendosi të mos procedojë më tej me shqyrtimin e dokumentacionit të mbetur për këtë bashkim shoqërish.

II.4. Në datën 24.05.2017, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, pasi ka pranuar ankesën e datës 22.05.2017 nga operatori ekonomik “Vëllezërit Hysa” sh.p.k. Komisioni i Vlerësimit të ofertave vendosi si më poshtë vijon:

1. “Alba Konstruksion” sh.p.k.	161.535.227	lekë	skualifikuar
2. “Biba X” sh.p.k.	161.874.915	lekë	skualifikuar
3. “Mela” sh.p.k.	165.000.000	lekë	skualifikuar
4. “Lala” sh.p.k.	180.258.791	lekë	skualifikuar
5. “2T” sh.p.k.	181.682.963	lekë	skualifikuar
6. “Vëllezërit Hysa” sh.p.k.	183.387.595	lekë	kualifikuar
7. “Shkëlqimi 07” sh.p.k.	183.500.000	lekë	skualifikuar
8. “G.P.G” sh.p.k.	184.821.851	lekë	skualifikuar
9. “Integrated Technology Services” sh.p.k.	209.573.979	lekë	skualifikuar
10. “PE – VLA – KU” sh.p.k.	213.810.384	lekë	skualifikuar
11. “4 AM” sh.p.k.	219.069.629	lekë	kualifikuar

II.5. Në datën 12.05.2017, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me pretendimin si më poshtë vijon:

[...]

Së pari, shoqëria "Biba" X , ka plotësuar dhe përmbushur kërkesën 2.a. të Kriterëve/Kërkesave të Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit për procedurën prokuruese me objekt "Rikonstrukcion i rrugës "Ura e Curumit – Zhabiak – Ura e Cepanit". Për të plotësuar këtë kriter, subjekti "Biba X" sh.p.k. ka paraqitur vërtetimin lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Nr. 2884/1 Prot., datë 24.03.2017. Sipas vërtetimit të paraqitur, shuma në vlerën 10.101.319 lekë, që ju e konsideroni si kriter për skualifikim pasi nuk është ankimuar në Gjykatë, sic e përcakton dhe vërtetimi është lidhur marrëveshje me organet tatimore për pagesën me këste. Në bazë të nenit 77 të Ligjit "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", subjekteve për shkak të një rrethane financiare i jepet e drejta të paguajnë detyrimet në marrëveshje me këste. Në kuadrin e kësaj marrëveshje, vlera 10.101.319 lekë nuk konsiderohet detyrime tatimore për sa kohë vetë organet tatimore në bazë të legjislacionit tatimor bien dakort në një marrëveshje me këste. Për sa më sipër parashtruar, subjekti Biba X ka plotësuar kriterin 2.a. të kërkesave të përgjithshme të kualifikimit përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Së dyti, në arsyen e skualifikimit referoni citoj: "Duke qenë se kjo është një e metë thelbësore, komisioni vendosi të mos procedojë më tej me shqyrtimin e dokumentacionit të mbetur për këtë bashkim shoqërisht", duke shkelur nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", nenin 46 "Kualifikimi i Ofertave", nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave" si dhe nenin 46 dhe 53 të LPP. Institucioni juaj në kundërshtim me këto nene, nuk ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve "Biba X" sh.p.k. & "Arti" sh.p.k. & "Senka" sh.p.k, përfaqësuar nga "Biba X" sh.p.k. Është shkelur dhe neni 2 i LPP. Vendimi i refuzimit të subjektit tonë është i diskriminuar dhe jo i barabartë me subjektet e tjera. Për sa më sipër ju kërkojmë të rishikoni vendimin tuaj për refuzimin e ofertës paraqitur nga "Biba X" sh.p.k. & "Arti" sh.p.k. & "Senka" sh.p.k, përfaqësuar nga "Biba X" sh.p.k.

II.6. Në datën 15.05.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.503/1 prot datë 15.05.2017 i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën e operatorit ekonomik "Biba X" sh.p.k. me arsyetimin si më poshtë:

[...] Lidhur me pretendimin e ankimuesit mbi arsyet e skualifikimit, në shtojcën 10 "Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit", pika 2 të dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi përcaktohet se:

Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: Një dokument që vërteton se subjekti juaj

- a) Ka plotësuar detyrimet fiskale
- b) Ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore të lëshuara nga Administrata Tatimore.

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se shoqëria “Biba X” sh.p.k. në përmbushje të kriterit sa më sipër ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- *Vërtetim Nr.2884/1 prot datë 24.03.2017 me përmbajtje si vijon: Vërtetohet se tatimpaguesi “Biba X” sh.p.k.....deri në datën 24.03.2017 rezulton me detyrime tatimore në shumën 19.425.556 lekë gjithsej, për të cilat sqarojmë se për detyrimet tatimore në vlerën 10.101.319 lekë tatimpaguesi ka lidhur marrëveshje për pagesë me këste, për detyrime tatimore në vlerën 9.324.237 lekë janë detyrime të cilat ndodhen në proces ankimi administrativ (Gjykatë).*

Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesave, gjykon se, skualifikimi prej autoritetit kontraktor i një operatori ekonomik pjesmarrës në një procedurë prokurimi me argumentin se “ka detyrime tatimore të pashlyera”, kur me këto të fundit nënkuptohen vetëm gjoba të cilat janë proces ankimi, nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurim publik. Në rastin konkret, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesave nënvizon se me anë të vërtetimit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, operatori ekonomik “Biba X” sh.p.k. nuk ka vërtetuar se ndodhet në rastin e sipërcituar. Në rastin konkret, dokumenti i lëshuar nga organet e administratës tatimore konfirmon faktin se ankimuesi rezulton të ketë detyrime tatimore të papaguara. Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioni gjykon se, skualifikimi prej autoritetit kontraktor i një operatori ekonomik pjesmarrës në një procedurë prokurimi me argumentin se “ka detyrime tatimore të pashlyera”, kur me këto të fundit nënkuptohen detyrime dhe interesa (jo gjoba) edhe në hipotezën se janë në proces apelimi apo është lidhur marrëveshje për pagesë me këste është i drejtë dhe tërësisht në përputhje me frymën dhe parashikimet ligjore të LPP. Sa më sipër, pretendimi i parashtruar nga operatori ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit se autoriteti kontraktor nuk ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesave vëren se: bazuar në nenin 53, pika 3 të LPP, komisioni gjykon se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Për sa më sipër, pretendimi i parashtruar nga operatori ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.7. Në datën 24.05.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 29.05.2017 me anë të shkresës nr. 503/4 prot datë 25.05.2017, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se *“Shoqëria “Biba X” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën 2.a. të Kërkesave të Përgjithshme për Kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve fiskale pasi sipas vërtetimit të paraqitur rezulton se ka detyrime tatimore në shumën 10.101.319 lekë, për të cilat nuk është ankimuar në gjykatë. Duke qenë se kjo është një e metë thelbësore, komisioni vendosi të mos procedojë më tej me shqyrtimin e dokumentacionit të mbetur për këtë bashkim shoqërish.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon: *” Një dokument që vërteton se (subjekti juaj): a) ka plotësuar detyrimet fiskale, b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore , të lëshuar nga Administrata Tatimore. Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.”*

III.1.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “Biba X” sh.p.k. & “Arti” sh.p.k. & “Senka” sh.p.k., “Biba X” shpk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) dokumentacionin e mëposhtëm:

- I. Vërtetim Nr.2884/1 prot datë 24.03.2017 me përmbajtje si vijon: Vërtetojmë se tatimpaguesi “Biba X” sh.p.k.....deri në datën 24.03.2017 rezulton me detyrime tatimore në shumën 19.425.556 lekë gjithsej, për të cilat sqarojmë se për detyrimet tatimore në vlerën 10.101.319 lekë tatimpaguesi ka lidhur marrëveshje për pagesë me këste, për detyrime tatimore në vlerën 9.324.237 lekë janë detyrime të cilat ndodhen në proces ankimi administrativ (Gjykatë).

III.1.3. Në nenin 45, pika 2, gërmat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur: d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës”.*

III.1.4. Në nenin 28 pika 2 të Vendimit nr. 184, datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar” parashikohet se *“Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në*

kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë: a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit;

III.1.5. Duke qenë se një situatë e tillë nuk rregullohet nga lex specialis, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për interpretimin e togfjalëshit “detyrim tatimor” në rastet kur akti administrativ “Njoftim vlerësimi tatimor” është në proces shlyerje me këste, do të konsiderohet ose jo “detyrim” për qëllim të kualifikimi në procedurat e prokurimit publik, gjykon ti drejtohet për interpretim sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik). Për të arritur në vendimarrje të drejtë, K.P.P. gjykon se duhet ti drejtohet, ligjit të posaçëm (lex specialis) Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSh” të ndryshuar, në nenin 6 pika 3 parashikon se “Me detyrim tatimor” nënkupton “tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”. Në nenin 77 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSh” të ndryshuar parashikohet se “1. Kur një rrethanë financiare pengon tatimpaguesin për të paguar nëafat detyrimet tatimore, ai mund të lejohet të lidhë në çdo kohë marrëveshje pagese me këste. Në të njëjtën kohë tatimpaguesi duhet të vërtetojë që është në kushtet e pamundësisë financiare për të paguar të plotë detyrimin tatimor, si dhe të tregojë që pavarësisht nga rrethanat financiare, ai është në gjendje të përmbushë marrëveshjen. 2. Tatimpaguesi paraqet një kërkesë me shkrim, për të hyrë në një marrëveshje pagese me këste. Kërkesa duhet t’i drejtohet drejtorit të drejtorisë rajonale apo drejtuesit të njësisë të ngjashme me të dhe duhet të parashtrojë arsyet, që e pengojnë tatimpaguesin për të paguar detyrimet tatimore. 3. Marrëveshja e pagesës me këste bëhet me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës dhe nënshkruhet nga tatimpaguesi dhe drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të. Për të nënshkruar një marrëveshje të pagesës me këste, tatimpaguesi detyrohet të paguajë menjëherë të paktën njëzet për qind të vlerës së detyrimit, për të cilin lidhet marrëveshja. 4. Marrëveshja e pagesës me këste nuk mund të zgjasë më tepër se fundi i vitit kalendarik pasardhës. 5. Administrata tatimore mund ta refuzojë kërkesën për një marrëveshje pagese me këste ose të kërkojë garanci bankare, para se të hyjë në një marrëveshje të tillë. 6. Tatimpaguesi duhet të paguajë kamatëvonesë për të gjitha detyrimet tatimore, pagesa e të cilave shtyhet, sipas marrëveshjes së pagesës me këste. Në rastin kur tatimpaguesi hyn në një marrëveshje të pagesës me këste me administratën tatimore, duke filluar nga muaji që pason muajin në të cilin marrëveshja është vendosur deri në përfundimin e afatit të marrëveshjes, me kushtin që marrëveshja të jetë përmbushur tërësisht, tatimpaguesi paguan kamatëvonesë për detyrimin tatimor, pagesa e të cilit shtyhet, por nuk llogaritet gjobë për pagesë të vonuar sipas nenit 114 të këtij ligji. 7. Marrëveshja për pagesë me këste mund të lidhet për detyrime tatimore të vendosura nga administrata tatimore për një vlerësim tatimor të kryer, sipas nenit 68, të këtij ligji, si dhe për detyrime tatimore të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi. Përgjatë kësaj, administrata tatimore nuk hyn në një marrëveshje të pagesës me këste për detyrim tatimor të vetëdeklaruar nga

tatimpaguesi, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. 8. Në rastin kur për tatimpaguesin ka filluar mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore, hiqet urdhërbllokimi i llogarive bankare të tatimpaguesit, i vendosur në përputhje me nenin 90 të këtij ligji. Në rastin kur për tatimpaguesin ka filluar mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore, në përputhje me nenin 91, të këtij ligji, pavarësisht nga lidhja e marrëveshjes së pagesës me këste, administrata tatimore, për të siguruar pagesën e detyrimit tatimor nuk heq dorë nga kjo masë. Administrata tatimore nuk mund të lidhë një marrëveshje të pagesës me këste nëse ka filluar procedurat e shitjes në ankand të pasurive të konfiskuara për efekt të atij detyrimi tatimor të pashlyer, në përputhje me nenin 96 të këtij ligji. “

si edhe :

- i. Jurisprudences së Gjykatës Kushtetuese (inter allia Vendimin nr.16, datë 25.07.2008) në bazë së të cilës janë bërë dhe ndryshime në legjislacionin tatimor;
- ii. Vendimin Unifikues nr.4, datë 30.05.2011 të Gjykatës së Lartë – i cili inter allia në paragrafin nr.13 shprehet se: “Me “detyrim tatimor”, Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6/3 nënkupton “tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjrobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”. Dallohet qartësia në ligj që, për t’u marrë në shqyrtim ankimi, detyrimisht duhet që të parapaguhet, sipas aktit administrativ Njoftim-Vlerësimit, detyrimi tatimor, i cili duhet të ketë të përfshirë tatimin dhe kamatëvonesat. Gjrobat, megjithëse konsiderohen sipas nenit të cituar, si pjesë e detyrimit tatimor, nuk përfshihen, si pjesë e parapagimit të detyrimit, si një kusht i domosdoshëm për të marrë në shqyrtim ankimin administrativ.”

III.1.6. Lidhur me pjesën e detyrimeve në vlerën prej 10.101.319 lekë për të cilat tatimpaguesi dhe njëherazi anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, “Biba X” shpk ka lidhur marrëveshje me administratën tatimore, KPP sqaron se organi i Administratës Tatimore me anë të Akt-Marrëveshjes, ka lejuar pagesën me këste të detyrimeve sipas kushteve të akt marrëveshjes, duke i krijuar lehtësi operatorit për përmbushjen e detyrimeve fiskale. Paraqitja e vërtetimit të mësipërm në të cilin një pjesë e detyrimeve të operatorit ekonomik ankimues ende nuk janë shlyer por janë pjesë e Akt- Marrëveshjes, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, nuk mund të konsiderohet se përmbush kriterin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në shtojcën 8 pika 2 të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit “Për shlyerjen e detyrimeve fiskale”, pasi detyrimi konsiderohet i papërmbushur deri në momentin e pagesës së kështit të fundit, sipas kushteve të akt marrëveshjes. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon faktin se edhe në praktika të tij të mëparshme *mutatis mutandis* dhe *inter allia* është shprehur se paraqitja e një marrëveshje të lidhur me administratën tatimore për pagimin me këste nuk pasqyron në asnjë rast se operatori ekonomik nuk ka detyrime fiskale në kuptim të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

III.1.7. Sa më sipër, me anë të dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E. anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Biba X” shpk nuk ka vërtetuar se ka shlyer të gjithë detyrimet tatimore në fuqi, apo se vlera e detyrimit është vetëm gjobë për të cilat është paguar tatimi përkatës dhe interesat. Inter Allia në vendimarrjen e tij, K.P.P. ka adaptuar një interpretim të ngushtë e teleologjik të togflalëshit “detyrimet për pagimin e tatimeve” të parashikuar nga neni 45, pika 2, gërma “dh” i Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar), në funksion të një prej qëllimeve të këtij ligji, që është nxitja e pjesëmarrjes dhe e konkurrencës së operatorëve ekonomikë, në kuptim të rritjes së efikasitetit të procedurave të prokurimit publik. Në balancën mes përpjekjes për të siguruar pagesën e plotë të të gjithë elementëve të detyrimit tatimor, nga njëra anë, dhe mirpërdorimin e fondeve publike – që arrihet përpara së gjithash përmes një pjesëmarrje të gjerë e konkurruese të operatorëve ekonomikë, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ato raste kur nga operatori pjesëmarrës në procedurën e prokurimit është paguar tatimi përkatës dhe interesi, ndërkohë që gjoba është në proces ankimimi, autoriteti kontraktor nuk duhet ta skualifikojë këtë operator në lidhje me mospagimin e gjobës. Ndërsa gjoba do të paguhet në një kohë të dytë – nëse ankimi i operatorit rezulton i pasuksesshëm, dëmi që mund t’u vijë financave publike nga skualifikimi i një operatori që potencialisht mund të ketë ofertuar me çmimin më të ulët, por që është skualifikuar për mospagimin në kohë të saj, është i pariparueshëm. Në rastin konkret, K.P.P. gjykon se nuk ndodhemi në situatën e sipërcituar pasi anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Biba X” shpk nuk ka shlyer të gjithë detyrimet tatimore. Kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Në nenin 74 pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje” Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Biba X” sh.p.k. & “Arti” sh.p.k. & “Senka” sh.p.k., “Biba X” shpk, nuk përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Biba X” sh.p.k. & “Arti” sh.p.k. & “Senka” sh.p.k., “Biba X” shpk nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik “Biba X” sh.p.k. & “Arti” sh.p.k. & “Senka” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me objekt: “*Rikonstruksioni rrugës “Ura e Çurumit – Zhabiak – Ura e Çepanit*” me Nr. REF-73360-03-22-2017, me fond limit 261.111.695 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 24.04.2017 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 999 Protokolli; Datë 24.05.2017;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha